

Fillimi > -Kronikë

Terrorizuan qytetarët duke qëlluar me kallashnikov në ajër, arrestohen dy të rinjtë në Lezhë

30 Dhjetor, 2020 09:12 | 2 757 shfletime



Madhësia e tekstit: - +

- Policia e Lezhës ka arrestuar dy persona, pasi kanë terrorizuar qytetarët, duke qëlluar me armë zjarri në ajër.
- Gjatë aksionit, kanë rënë në pranga dy adoleshentë 18 dhe 19 vjeç, si dhe janë sekuestruar dy armë zjarri, një automatik dhe një pistoletë, si dhe fitil zjarrpërcjellës.

Njoftimi i policisë:

Shërbimet e DVP Lezhë, në bashkëpunim me Komisariatin e Policisë Lezhë, pas njoftimit të marrë se në fshatin Gajush, Lezhë, kishte të shtëna me armë zjarri, menjëherë kanë organizuar punën për identifikimin dhe kapjen e autorëve.

Falë veprimeve të shpejta profesionale dhe hetimore u bë i mundur identifikimi në kohë reale i 2 shtetasve që kishin qëlluar me armë zjarri në ajër.

Në bazë të provave të grumbulluara u organizua dhe finalizua operacioni policor i koduar “Gajushi”, si rezultat i të cilit u bë kapja e arrestimi i personave të dyshuar:

-R. H., 19 vjeç dhe S. H., 28 vjeç, banues në Milot, Kurbin.

Shërbimet e Policisë, gjatë kontrollit të banesës së shtetasit R. H. dhe ambientit përreth saj, gjetën dhe sekuestruan armën e zjarrit kallashnikov me të cilën dyshohet se këta shtetas kanë qëlluar në ajër, të cilën ky shtetas e kishte fshehur në një depozitë uji në banesën e tij. Operacioni ka vijuar me kontrollin e banesës së shtetasit S. H., ku gjatë kontrollit shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan një armë zjarri pistoletë me një krehër dhe fitil zjarrpërcjellës.

Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për veprime të mëtejshme, për veprat penale “Armëmbajtja pa leje ” dhe “Prishja e rendit dhe qetësisë publike”.

(BalkanWeb)

Për t'u bërë pjesë e grupit "Balkanweb" mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)

Etiketa: arrestim lezhe

TË NGJASHME

Në kërkim nga Austria, arrestohet shqiptari 23-vjeçar në Spanjë, grabiste banesa

05 Janar, 2021

Terrorizoi familjen dhe lagjen duke qëlluar me kallashnikov në gjendje të dehur, kush është 45-vjeçari i arrestuar në Elbasan

05 Janar, 2021

Shfaq Komentet (0)

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

E rëndë në Elbasan, vetëvritet me armë gjahu 59-vjeçari, çfarë dyshon policia

05 Janar, 2021

E rëndë në Tiranë, hidhet nga lartësia e pallatit ku banonte një 37-vjeçar

05 Janar, 2021

Policia nxjerr shifrat, në 5 ditë 1183 qytetarë morën gjoba për maskat, thyerjen e protokolleve të sigurisë dhe daljen pas orës policore

05 Janar, 2021

VIDEO/ Qëlloi në ajër pas konfliktit familjar, gjendet arma kallashnikov në Elbasan, autori e kishte hedhur tek fqinji

05 Janar, 2021

VIDEO/ Sekuestrohen 29 kallëpe me eksploziv dhe 15 kapsolla detonatore në Durrës, në pranga dy kuksianët, do i shisnin për 12 mijë euro

05 Janar, 2021

SHÇBA procedon 7 punonjës policie pas arratisjes së 30-vjeçarit nga komisarati. Ja akuza

05 Janar, 2021

KATEGORIA VIDEO

Meta për projektin Vlorë-Orikum: E kam vënë në dijeni Ramën 4 herë kur ishte ministër i Jashtëm, s'kam marrë asnjë përgjigje

05 Janar, 2021

Projekti i rrugës Vlorë-Orikum, Meta: Ministria e Financave deklaroi se nuk pati negociata me Fondin Saudit, si u shkelën kërkesat e Kushtetutës

05 Janar, 2021

“E di gjithë Vlora se Meta bllokoi projektin”! Presidenti i përgjigjet Ramës: Ju i kërkuat Fondit Saudit ndërprerjen e marrëveshjes

05 Janar, 2021

VIDEO/ Shqipëria në sytë e Brdaric, trajneri zbulon Shkodrën e tij, problemet dhe strategjinë e re, a do të qëndrojë gjatë tek Villaznia?

Senad Nikshiqi | 05 Janar, 2021

Ish-ministri Dëmir Bushati: Gjykata jep vendimin përfundimtar, por nuk e 'mat' detin. Ja çfarë do të bëjnë Shqipëria e Greqia

05 Janar, 2021

VIDEO/ Qëlloi në ajër pas konfliktit familjar, gjendet arma kallashnikov në Elbasan, autori e kishte hedhur tek fqinji

05 Janar, 2021

FAQET ZYRTARE

News24
Gazeta Shqiptare
Radio RASH

PRIVATËSIA

POLITIKA E PRIVATËSISË

KONTAKT

redaksia@balkanweb.com

EMISIONE NEWS24

Alert
Emisioni Chic
Emisioni Diplomaticus
Emisioni Vila 24
Kjo Javë
Klinika 24
Koha për t'u zgjuar
Me zemër të hapur
Monitor Ekonomi
Real Story
Shqiptarët për shqiptarët
Sport News
Sport News Plus

KATEGORI

Fillimi
Shqipëria
Kosova
Rajoni
Sport
Bota
Kulturë
Metropol
Analiza
Teknologji

MEDIAT E HUAJA

New York Times
Guardian
WEB BBC
WEB CNN
REUTERS
Washington Post
Times Online
Financial Times
WEB Yahoo
WEB MSN
USA Today

